

## **Subjekti: “Shprehje Interesi për Fasilitator”**

I/E nderuar,

Nevo Koncepti ju fton të shprehni interesimin tuaj për pozitën e Fasilitatorit për Edukimin Joformal për të Rritur, përmes metodologjisë “Your Story”, në kuadër të projektit: “Rritja e përfshirjes në edukimin parashkollor dhe fillor për fëmijët Romë – Faza II” (ECD-KOS-03).

### **Qëllimi i angazhimit**

Fasilitatori/ja do të jetë përgjegjës/e për organizimin dhe lehtësimin e sesioneve javore edukative me nëna Rome, me qëllim të:

- rritjes së aftësive të leximit,
- forcimit të aftësive prindërore, dhe
- ndërgjegjësimit për sigurinë digjitale.

Këto sesione synojnë të krijojnë një mjedis social, gjithëpërfshirës dhe mbështetës, ku nënat ndihen të fuqizuara për të marrë një rol aktiv në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre.

### **Kualifikimet e kërkuara:**

- Të jetë prind ose student/e që e njeh mirë komunitetin Rom dhe është i/e familjarizuar me jetesën dhe nevojat e tij;
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikuese;
- Njohuri të gjuhës shqipe (njohuria e gjuhës rome përbën përparësi);
- Njohuri bazike mbi përdorimin e mjeteve dhe platformave digjitale.

### **Dokumentet e kërkuara për aplikim**

- CV, dhe Ofertë financiare për ditë pune (përmes email).

**Për më shumë informacione, në dokumentet e bashkëngjitura gjeni përshkrimin e detajuar të pozitës.**

### **Afati i dorëzimit**

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen deri më **[24.03.2026]**, ora 16:30, në adresën e emailit: [prokurimi@nevokoncepti.org](mailto:prokurimi@nevokoncepti.org)